

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarëve të EULEX-it Tore Thomassen dhe Gerrit-Marc Sprenger, gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Nazmije Ibrahimimi dhe Valdete Daka si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore Chiara Rojek në cilësi të procesmbajtëses,

Në lëndën penale kundër **SP**, nofka *****, i biri i SaP dhe IM, i lindur më ***** në fshatin *****, Komuna *****, *****, shtetas i Bosnjës dhe Hercegovinës, banor i *****, *****, BeH, i shkurorëzuar dhe ka katër fëmijë, ka të kryer shkollën fillore, automekanik me të ardhura 1.000 Euro në muaj, me gjendje ekonomike mesatare, në paraburgim prej 3 shkurt 2010, dhe **HS**, i biri i RS dhe BH, i lindur më ***** në fshatin *****, *****, Kosovë, me vendbanim në *****, rruga *****, i martuar, ka pesë fëmijë, ka të kryer shkollën e mesme, automekanik me të ardhura 300-500 Euro në muaj kur është i punësuar, me gjendje ekonomike mesatare, në paraburgim prej 22 shkurt 2010,

Të akuzuar sipas aktakuzës PPS nr. 23/2010 – GJPP nr. 11/2010 të ngritur më 16 korrik 2010 nga prokuroria speciale e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për veprat penale të Krimin të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së,

I dënuar në shkallë të parë me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 të datës 23 shkurt 2011, me të cilin SP u shpall fajtor për veprën penale të Krimin të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 1 të KPK-së dhe Blerje, posedim, shpërndarje dhe shtije të paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së, me dënim unik me tetë (8) vjet burgim dhe me 51.00 euro gjobë, dhe me të cilin HS u shpall fajtor për veprën penale të Krimin të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 3 dhe Blerje, posedim, shpërndarje dhe shtije të paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së, dhe u dënua me dënim unik me 10 (dhjetë) vjet burgim dhe me 51.00 euro gjobë,

Dënim ky i konfirmuar në shkallë të dytë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 të datës 18 janar 2012,

Duke vepruar sipas Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i pandehuri SP më 29 qershor 2012 dhe Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës

Mahmut Halimi në emër të të pandehurit HS më 20 qershor 2012, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 të datës 23 shkurt 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 të datës 18 janar 2012, dhe duke marrë parasysh Mendimin dhe Propozimin ndaj kërkesave të paraqitura nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) më 23 korrik 2012, pas votimit dhe këshillimit të mbajtur më 14 gusht 2012,

Në përputhje me nenet 451 dhe tutje të KPPK-së, lëshon këtë

AKTGJYKIM

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i pandehuri SP më 29 qershor 2012 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 të datës 23 shkurt 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 të datës 18 janar 2012, **HEDHET POSHTË** si e palejueshme, në përputhje me nenin 451 paragrafin 2 të KPPK-së.
2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit HS kundër të dy aktgjykimeve **REFUZOHET** si e pabazuar, në përputhje me nenin 456 të KPPK-së.
3. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 i datës 23 shkurt 2011 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 i datës 18 janar 2012, **VËRTETOHEN** në tërësi.

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

Më 16 korrik 2010, Prokuroria Speciale ngriti aktakuzën PPS nr. 23/2010 – GJPP nr. 11/2010 e datës 13 korrik 2010 kundër HS dhe SP për veprat penale të lartpërmendura. UJ dhe EM u akuzuan për veprat penale të Krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 1 lidhur me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së.

Më 7 shtator 2010, u konfirmua aktakuza në tërësi me aktvendimin KA nr. 56/2010.

Më 23 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë lëshoi aktgjykimin P nr. 36/2010. I pandehuri SP u shpall fajtor për vepër penale të Krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 1 të KPK-së (pika 1) dhe veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së (pika 2).

Ai u dënua me shtatë (7) vjet burgim dhe me 50.00 euro gjobë (pika 1), dhe me tri (3) vjet burgim dhe me 50.00 euro gjobë (pika 2). Ndaj tij u shqiptua dënimi unik me tetë (8) vjet burgim dhe me 51.00 euro gjobë.

HS u shpall fajtor për Krim të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 3 (pika 1) dhe veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së (pika 2) dhe u dënua me tetë (8) vjet burgim dhe me 50.00 euro gjobë (pika 1), dhe me tri (3) vjet burgim dhe 50.00 Euro gjobë (pika 2). Ndaj tij u shqiptua dënimi unik me dhjetë (10) vjet burgim dhe me 51.00 euro gjobë.

I bashkë-akuzuari i tretë u dënua dhe i bashkë-akuzuari i katërt u lirua.

Më 18 janar 2012, Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi aktgjykimin Ap-Kz nr. 255/2011 me të cilin refuzohen ankesat e ushtruara në emër të tre të pandehurve, dhe vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Më 3 maj 2012, avokati Adem Vokshi paraqiti Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të SP, e cila u refuzua me aktgjykimin Pkl-Kzz nr. 80/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 14 qershor. Avokati mbrojtës Mahmut Halimi paraqiti Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të të pandehurit HS më 20 qershor 2012, dhe i pandehuri SP paraqiti Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë më 29 qershor 2012.

II. Parashtrirat e mbrojtjes dhe përgjigja e ZPSHK-së

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga i pandehuri SP

SP paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale nga neni 451 paragrafi 3 lidhur me nenin 403 paragrafin 2 pikën 1 të KPPK-së, dhe i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta anulojë aktgjykimin e kontestuar, dhe ta kthejë lëndën në rigjykim; ose ta zvogëlojë dënimin. Ai kërkon edhe të ndërpritet paraburgimin në përputhje me nenin 420 paragrafin 1 pikën 3 lidhur me nenin 424 paragrafët 1 deri 4 të KPPK-së. Sipas tij, gjykata e shkallës së parë dhe së dytë kanë bërë shkelje të procedurës penale nga neni 71 paragrafi 1 i KPK-së të cilat ndikuan në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, kur shqiptuan dy dënime për të njëjtën vepër.

I pandehuri pretendon se ka mospërputhje në mes disa dëshmive të bashkë-akuzuarit, EM, të dhëna në Polici dhe në Prokurori, dhe parashtron se EM tentonte ta përfshinte atë. Ai pohon se nuk është penalisht përgjegjës, dhe se FM, babai i EM, ishte i përfshirë në biznesin e drogës dhe në kurthin e HS. Ai përmend gjendjen e tij personale, p.sh. të qenit baba i katër fëmijëve të mitur. Ai në fund i referohet lirimit të UJ-it, dhe dallimit të trajtimit të dënimit në mes HS dhe EM.

2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit HS

Mbrojtja e bazon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 451 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3 lidhur me nenin 403 paragrafin 2 pikën 10 dhe 12 të KPPK-së. Avokati Halimi i sugjeron Gjykatës Supreme të Kosovës ta ndryshojë atë në mënyrë që ta lirojë HS në përputhje me nenin 390 pikën 3 të KPPK-së, ose ta ndryshojë atë duke specifikuar veprimet e të pandehurit lidhur me veprën penale të Krimin të organizuar, të shqiptojë një dënim më të lehtë, ose t'i anulojë aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë dhe ta kthejë lëndën në rigjykim. Ai në fund propozon të ndërpritet ose të shtyhet zbatimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me nenin 454 paragrafin 4 të KPPK-së.

Ai pohon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse Prokurori i Shtetit ndryshoi aktakuzën kundër të pandehurit S duke ri-cilësuar veprën penale sipas nenit 25 të KPPK-së (ndihma). Gjykata është dashur t'i përgjigjet ndryshimit të Prokurorit të Shtetit në dobi të të akuzuarit, në pajtim me nenin 413 paragrafin 5.

Mbrojtja parashtron se gjykata e shkallës së parë veptoi në kundërshtim me nenin 387 paragrafin 1 dhe nenin 231 paragrafin 2 pikën 5 të KPPK-së, me mos vlerësimin e provave të paraqitura nga mbrojtja, dhe kryesisht duke u mbështetur në dëshmitë e procedurës paraprake në marrjen e vendimit mbi fajësinë e të pandehurve. Gjykata e shkallës së dytë vetëm i ka vërtetuar këto gjetje. Mbrojtja po ashtu pretendon në kundërtënie në mes arsyetimit të aktgjykimit dhe përmbajtjes së procesverbalit të dëshmive dhe letrave, p.sh. raportet e policisë lidhur me sjelljen e EM dhe aludimin në HS në deklaratat e tij në njërin anë dhe arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë në anën tjetër. Ai pohon se disa prova kundër tij janë fabrikuar nga tre policë.

Avokati mbrojtës pretendon se refuzimi i kolegjit për ankesa për të dëgjuar YK si dëshmitar. Ky individ ka qëndruar në dhomë bashkë me EM në burgun e Dubravës në shkurt dhe ka pasur njohuri në lidhje me kontaktet telefonike në mes EM dhe dëshmitarit MT, dhe motivet e dëshmitarit. Mbrojtja gjithashtu pretendon se propozimi për të dëgjuar FM është penguar pa sqarime të mjaftueshme. Avokati Halimi, i referohet premtimit të dhënë ndaj të pandehurit që të marrë shpërblimin (lirimin nga paraburgimi) nga hetuesit në kundërshtim të nenit 155 paragrafit 1 pikës e të KPPK-së.

Përfundimisht, mbrojtja pretendon në shkelje të ligjit penal, me shqiptimin e dy dënimeve për veprën penale Krim i organizuar dhe Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike edhe pse parimi i "absorbimit" është i aplikueshëm në Kosovë.

3. Përgjigja e Prokurorit të Shtetit

ZPShK-ja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që t'i refuzojë të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuara.

Sa i përket kërkesës së SP, Prokurori i shtetit thekson se gjykata e shkallës së parë ka bërë një vlerësim të detajuar të provave përfshirë deklaratat e EM dhe SP dhe ka dhënë një arsyetim të detajuar. Gjykata Supreme e Kosovës ka vepruar njëjtë në fazën ankimore. Gjithashtu, Prokurori i shtetit pohon se arsyetimi i Gjykatës së Qarkut për lirimin e UJ është i qartë. Prokurori është i mendimit se një analogji në mes të dy të pandehurve dhe provat janë çorientuese pasi që gjykata e shkallës së parë është mbështetur në provat vërtetuese për ta dënuar HS. Mungesa e gjurmëve të gishtërinjve të SP në peshore si dhe gjurmët e narkotikëve në veturën e UJ janë diskutuar në detaje në shkallën e parë dhe të dytë.

Në lidhje me HS, Prokurori i shtetit pohon se aktgjykimi i shkallës së parë është i bazuar në provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. ZPShK-ja i referohet argumenteve të lartpërmendura sa i përket kredibilitetit të pandehurit EM. Dëshmitari YK mund të ofroj vetëm prova thashetheme. Sipas mendimit të Prokurorit të shtetit, pretendimi se ZPShK-ja ka dorëzuar një ndryshim të aktakuzës në dobi të akuzuarit në kuptim të nenit 413 paragrafit 5 të KPPK-së, gjatë paraqitjes së mendimit të saj në ankesat e të pandehurve, nuk qëndron. Përfundimisht, Prokurori i shtetit pajtohet me arsyetimin e aktgjykimit në lidhje me parimin e absorbimit.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga SP është e palejueshme sipas nenit 451

paragrafit 2 të KPPK-së.

Ankesa e paraqitur në emër të HS është e pranueshme. Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon si të pabazuar sipas nenit 456 të KPPK-së.

1. Kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas neneve 454 dhe 26 paragrafit 3 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me nenin 3 paragrafin 7 të Ligjit mbi kompetencat.¹

2. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë

Aktgjykimi i fundit i kundërshtuar, aktgjykimi Ap-Kz nr. 255/2011, është shpallur më 18 janar 2012. I pandehuri SP e ka pranuar atë më 26 mars 2012. Kërkesa e tij e datës 25 qershor është paraqitur pranë shkrimores së gjykatës më 29 qershor. Vula e postës është e palexueshme për të vërtetuar datën e dërgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron kërkesën të palejueshme sipas nenit 451 paragrafit 2 të KPPK-së. Nuk ka interes legjitim juridik për procedurë të mëtutjeshme.

Gjykata Supreme tanimë ka vendosur lidhur me kërkesën në dobi të pandehurit, të paraqitur nga avokati i tij lidhur me arsye të ngjashme më 3 maj 2012. Aktgjykimi përmban arsyetim të detajuar i cili mbulon shumicën e aspekteve të kësaj kërkesë. Prandaj, ky kolegji i Gjykatës Supreme i referohet këtij aktgjykimi dhe arsyetimit të tij. Vlerësimi i plotë (dhe shqyrtim) i lëndës, i fakteve dhe ligjit, tanimë është bërë në nivelin e shkallës së parë dhe të dytë në pajtim me dispozitat e Kodit dhe standardeve të drejtave të njeriut.² Gjykata Supreme e Kosovës, më tutje ka ekzaminuar ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore përfundimtare në këtë lëndë gjatë vendosjes lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në qershor 2012.

Neni 451 paragrafi 2 i KPPK-së në mënyrë të qartë nuk lejon paraqitjen e kërkesës “kundër një vendimi të Gjykatës Supreme të Kosovës në të cilin është vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e mbështet këtë interpretim.” Vetëm një kërkesë mund të paraqitet kundër një vendimi gjyqësor përfundimtar, e lëre më kërkesat që kanë të bëjnë me paraburgimin nën nenin 451 paragrafin 4 të KPPK-së. Një përjashtim gjendet në paragrafin 4 të nenit 452 të Kodit i cili thotë “Kur me vendim të Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut është vërtetuar se me vendim përfundimtar janë shkelur të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit, afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë ec nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut i dorëzohet të pandehurit.” Ky lexim i dispozitave procedurale është në

¹ Ligji nr. 03/L-53 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i datës 13 mars 2008

² Shih nenin 2 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 (KEDNj), e datës 22 nëntor 1984: (1) Kushdo që shpallet fajtorë nga Gjykata për një vepër penale ka të drejtë që fajësia dhe dënimi i tij të shqyrtohet nga një Gjykatë më e lartë. Ushtrimi i kësaj të drejte, përfshirë arsyet mbi të cilat mund të ushtrohet, do të udhëhiqen me ligj. (2) Kjo e drejtë mund t'i nënshtrohet përjashtimeve në lidhje me veprat penale të karakterit të vogël, siç është përcaktuar me ligj, ose në rastet në të cilat personi në fjalë është gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata më e lartë ose është shpallur fajtorë pas ankesës kundër lirimit; shih *inter alia* Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të datës 16 dhjetor 1966, neni 14 (5); Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, neni 32 mbi të drejtën për mjete juridike dhe nenin 54 Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave të Kushtetutës së Kosovës

pajtim me procedurën për mjetet e jashtëzakonshme të miratuar nga shumica e shteteve Evropiane.³

Aktgjykimi i kontestuar i është dërguar HS më 26 mars dhe avokatit të tij mbrojtës më 22 mars. Kërkesa e paraqitur nga avokati Mahmut Halimi është regjistruar në gjykatë më 20 qershor. Prandaj, kjo kërkesë është e pranueshme sepse është paraqitur brenda afatit prej tre muajve nga personi i autorizuar, sipas neneve 452 paragrafit 3 dhe 453 të KPPK-së.

3. Meritat e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur në emër të pandehurit HS

Pretendimi se është bërë shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal sipas nenit 451 paragrafit 1 pikave 1, 2, 3 në lidhje me nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me parashtrësën e Prokurorit të shtetit dhe për këtë arsye refuzon këtë pretendim si të pabazuar. Në përgjigje të ankesës së HS, Prokurori i shtetit ka paraqitur mendimin dhe propozimin e datës 30 shtator 2011, me anë të cilit ZPShK-ja propozon të ri-cilësohet akti si Ndihmë në Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, sipas leximit të kombinuar të nenit 229 paragrafëve 2 dhe 4 nën-paragrafit 1 në lidhje me nenin 25 të KPK-së, dhe Krim i organizuar sipas nenit 274 paragrafit 2 të KPK-së – jo si lider i grupit, dhe në pajtueshmëri të ri-llogaritjet dënimi unik eventual. Prokurori i shtetit në mënyrë të qartë i referohet nenit 409 paragrafit 2 të KPPK-së si bazë e këtij propozimi, i cili thotë “Me rastin e kthimit të lëndës, prokurori publik mund të paraqesë propozim ose të deklarojë se atë do ta paraqesë në seancën e kolegjit të apelit. Gjykata Supreme konstaton se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet për zbatimin e nenit 413 paragrafit 5. Kjo dispozitë në mënyrë të qartë kërkon që të mbahet shqyrtimi sipas nenit 412 të Kodit, kurse propozimi i Prokurorit të shtetit i datës shtator 2011 është paraqitur shumë kohë para seancës ankimore. Gjithashtu është vërejtur se kolegji për ankesa nuk ka zbatuar propozimin e prokurorit të shtetit që propozonte ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale. Në fakt, gjykata e shkallës së dytë nuk obligohet nga propozimi dhe mendimi i paraqitur ndaj ankesës nga ZPShK-ja.

Pretendimi se është bërë shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 2 në lidhje me nenin 387 paragrafin 1 dhe nenin 231 paragrafin 2 pikën 5 të KPPK-së

Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu refuzon këtë argument. Pas shqyrtimit të aktgjykimit të shkallës së parë, ky kolegji vëren se Gjykata e Qarkut ka vlerësuar të gjitha deklaratat e të bashkëpandehurve dhe dëshmitarëve, ato të marra në fazën e procedurës paraprake dhe ato të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pastaj, Gjykata ka proceduar me vlerësim të gjatë të këtyre deklaratave dhe kredibilitetit të dëshmitarëve dhe të bashkëpandehurve për të arritur në

³ Shih *inter alia* Kodin e Procedurës Penale të Gjermanisë, Kapitulli IV Ankesa mbi pikat e ligjit; Kodi i Procedurës Penale të Francës Titulli I Ankesat e Kasacionit, neni 567; Kodi i Procedurës Penale të Polonisë, Akti i 6 qershorit 1997, Pjesa XI ankesat e jashtëzakonshme, Kapitulli 55

përfundim në bazë të gjitha provave të administruara.⁴

Kolegji i Gjykatës Supreme pranon kompleksitetin e lëndës, pasi që provat bazë janë kryesisht deklaratat e EM, dhe ato të bashkëpandehurve. Sidoqoftë, gjykata e shkallës së parë ofron sqarime të qëndrueshme mbi gjetjet e saj në bazë të provave në dispozicion, përfshirë elementet vërtetuese. Vlerësimi i provave është në kompetenca të trupit gjykues siç është paraparë me nenin 387 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit. Në këtë lëndë, gjykata e shkallës së parë ka arritur dejtë në përfundim se deklaratat e EM në procedurën paraprake kanë qenë më të besueshmet dhe se pohimet e reja të bëra nga ky i akuzuar nuk do të merren parasysh. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Qarkut nuk ka bërë asnjë shkelje e cila mund të ndikoj në mënyrë të konsiderueshme të drejtat e mbrojtjes. Prandaj, ky kolegji plotësisht pajtohet me gjetjet e shkallës së dytë në lidhje me këtë.⁵

Po ashtu, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës së parë ka proceduar me një ekzaminim të detajuar të pretendimeve të mbrojtjes se provat kundër HS janë fabrikuar, dhe nuk gjen asnjë kundërthënie në mes të përmbajtjes së procesverbalit, deklaratave dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Sa i përket pretendimit në lidhje me dëshmitarët potencial YK dhe FM, Gjykata Supreme e konsideron si jo meritor. Gjykata e shkallës së dytë, pa i shkelur të drejtat e mbrojtjes, p.sh. për ekzaminimin e dëshmitarëve ose dëshmitarët tanimë të ekzaminuar, ka refuzuar propozimin e HS për të hapur një seancë dhe për të ftuar YZ në gjykatë gjatë seancës ankimore. Sipas mbrojtjes, individi i cili ka qëndruar së bashku në dhomë me EM në burgun e Dubravës, e ka ditur për kontaktet telefonike në mes EM dhe dëshmitarit MT. Gjykata Supreme vërteton se një dëshmi e tillë do të ishte provë thashetheme e cila nuk do të kishte ndonjë ndikim në rezultatin e procedurës. Në lidhje me FM, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut e ka lexuar në gjykatë deklaratën e tij të dhënë në procedurën paraprake. Prandaj, kolegji i nënshkruar më poshtë pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë.⁶

Gjykata Supreme gjithashtu refuzon pretendimin se policët kanë negociuar me HS, gjë që nuk është e mbështetur në këtë rast. Gjithashtu, mbrojtjes i përkujtohet se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet në bazë të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Sa i përket parashtrësës në lidhje me shqiptimin e dy dënimeve për kryerjen e veprës penale Krimi i organizuar në njërën anë dhe veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në anën tjetër ('parimi i absorbimit), Gjykata Supreme nuk e sheh të nevojshme të përsëris gjetjet e kërkesës së parë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe prandaj i referohet aktgjykimit të mëparshëm Pkl-Kzz nr. 80/2012. Duke e pasur parasysh atë që u tha më lartë, kërkesa e mbrojtjes për ndërprerjen ose shtyrjen e zbatimit të vendimit gjyqësor përfundimtar sipas nenit 454 paragrafit 4 të KPPK-së, refuzohet.

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Horst Proetel

Anëtare e kolegjit

Anëtare e kolegjit

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Nazmije Ibrahim

Anëtar i kolegjit

⁴ Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, P nr. 36/2010, aktgjykimi i shkallës së parë, 23 shkurt 2011, faqet 8 dhe në vazhdim

⁵ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 255/2011, Aktgjykimi i ankimuar, 18 janar 2012, faqet 12-13, par. 66-70

⁶ Ibid, faqet 11-12, paragrafët 59-65

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Valdete Daka

Gjyqtar i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger

Anëtar i kolegjit

Procesmbajtëse

Gjyqtar i EULEX-it Tore Thomassen

Zyrtare ligjore Chiara Rojek

Gjykata Supreme e Kosovës

Pkl-Kzz 109/2012

14 gusht 2012

Prishtinë